



Republika e Kosovës - Republika Kosovo
Komuna e Gjakovës - Opština Djakovica
Zyra e Përgjithshme Administrative
Zyra për Postë, Administrativë dhe Postë
01 Nr./Br. 41361-21045
Data/Datum 03.08.2021
Gjakovë-Djakovica-Gjakova

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komuna e Gjakovës
Opština Djakovica - Municipality of Gjakovë



MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Prishtinë

03.08.2021

Palët në marrëveshje:

1. Ministria e Shëndetësisë, përfaqësuar nga Dr. Naim Bardiqi, Sekretar i Përgjithshëm
2. Komuna e Gjakovës, përfaqësuar nga Z. Ardian Gjini, Kryetar i Komunës.

Neni 1

Qëllimi i marrëveshjes:

Dhënia në përdorim të **përhershëm** të autoambulancës Opel e re pa tabela nr. Shasie WOVMR8609MB250012 për nevojat dhe aktivitetet e shërbimeve shëndetësore.

Neni 2

Obligimet e palëve nënshkruese:

1. Ministria e Shëndetësisë ia kalon në përdorim të përhershëm KK Gjakovë autoambulancën.
2. Ministria e Shëndetësisë nuk obligohet në asnjë mënyrë t'i kompensojë shpenzimet e krijuara nga përdorimi i autoambulancës përfshirë mirëmbajtjen, furnizimin me karburante, vajra, regjistrim, taksë apo raste të aksidentit.
3. Komuna Gjakovë obligohet t'i bartë të gjitha shpenzimet të cilat rrjedhin nga përdorimi i autoambulancës në fjalë.

Neni 3

Marrëveshja hyn në fuqi prej momentit të nënshkrimit nga palët nënshkruese dhe është në tri kopje origjinale.

Ministria e Shëndetësisë

Dr. Naim Bardiqi
Sekretar i Përgjithshëm

Komuna - Gjakovë

Z. Ardian Gjini
Kryetar

